

Gjuajti me armë nga shtëpia e tij në Prishtinë, në shtëpi i gjenden armë e antiplumb – Dërgohet në mbajtje për 48 orë i dyshuari



06/03/2025 08:32

f

t

s

Një person është arrestuar në Prishtinë pasi që nga shtëpia e tij ka gjuajtur me armë zjarri.

Njesitet e specializuara të Policisë së Kosovës, NJSI dhe K-9 kanë intervenuar dhe kanë arrestuar të dyshuarin.

Nga kontrolli në shtëpi, i janë gjetur dhe konfiskuar pushkë gjuetie, armë, fishekë, gëzhoja, karikatorë, antiplumb e telefon, shkruan [lajmi.net](#).

Nuk ka persona të lënduar ndërsa i dyshuari me vendim të prokurorit u dërgua në mbajtje për 48 orë.

“Prishtinë 05.03.2025 – 23:10. Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar, pasi që nga shtëpia e tij kishte gjuajtur me armë zjarri. Njësitet e specializuara të PK-së NJSI dhe K-9 kanë intervenuar dhe kanë arrestuar personin e dyshuar. Janë kontrolluar shtëpia dhe objektet përçjellëse të personit të dyshuar, janë gjetur dhe konfiskuar: një pushkë gjuetie, një armë e shkurtër pistoletë, 13 fishekë 9 mm, 64 fishekë të pushkës së gjuetisë, 12 gëzhoja 9 mm, dy karikatorë, rrip brezi për fishek, dy antiplumb, dhe telefon. Nuk raportohet për persona të lënduar. I dyshuari me vendim të prokurorit dërgohet në mbajtje për 48 orë. Rasti nën hetime”, ka njoftuar Policia e Kosovës përmes raportit 24 orësh. [/Lajmi.net/](#)

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
By LuponMedia



Artikuj të ngjashëm



March 6, 2025

Tjetër takim: Zyrtarët ukrainas dhe amerikanë pritet të takohen javën tjetër...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
B.r. Zenel Salihu nr. 28, zyrya nr.

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information

RRJETET SOCIALE

